

## Njoftim për zgjedhjet e përgjithshme në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj 2024

Bazuar në dispozitat e Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), dokumentit Rregulla dhe Procedurat për Zgjedhjet e Përgjithshme në UShAF, Këshilli Drejtues i UShAF në mbledhjen e mbajtur me datën 19.01.2024, ka marrë vendim për shpalljen e zgjedhjeve të përgjithshme 2024 të cilat do të mbahen me datën **16.02.2024**.

E tërë procedura e mbajtjes së zgjedhjeve të përgjithshme është e paraparë në Dinamikën e zgjedhjeve dhe ato do të mbahen për:

1. Anëtar të Këshillit Mësimor/Shkencor nga radhët e personelit akademik
2. Anëtar të Këshillit Mësimor/Shkencor nga radhët e personelit joakademik
3. Anëtar i Senatit nga radhët e personelit akademik
4. Anëtar i Senatit nga radhët e personelit joakademik
5. Drejtor i programit të studimit.

Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj inkurajon të gjithë stafin akademik dhe joakademik që të marrin pjesë në zgjedhje dhe të votojnë për kandidatët të cilët sipas tyre do të përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat në organet e UShAF.

Regjistrimi i kandidaturave për pozitat e lartëshënuara do të bëhet më datën **08.02.2024** nga ora 08:00 deri 16:00 në Zyrën nr. 008.

Për informata më të hollësishme lidhur me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, kontaktoni në email adresën [info@ushaf.net](mailto:info@ushaf.net)

Kryesuesi i Komitetit të  
Armend Hysa

